



VENDIM

Nr. 12 Datë 05/ 07/ 2017

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT TË REDUKTUAR PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT ME KOHË TË PLOTË TË CIKLIT TË DYTË NË FAKULTETET E UNIVERSITIT TË ARTEVE NE VITIN AKADEMIK 2016-2017

Mbështetur në shkresën e Ministres së Arsimit dhe Sporteve, me nr. 5171 Prot; datë 17/05/2017 në të cilën sugjerohet: që, IALT të vlerësojnë me prioritet studentët e kategorive sociale në nevojë, si dhe studentët e ekselencës që ndjekin studimet e ciklit të dytë për vitin akademik 2017-2017, për të përcaktuar tarifat e studimit si dhe rastet përjashtimore me tarifa vjetore të shkollimit në përputhje me ligjin 80/2015 datë 22/07/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL", neni 49 pika 1/ë..

Për këtë procedurë referuar Vendimit VKM nr.638, datë 22/07/2015 ndryshuar me VKM 866 datë 23/10/2015 "Për kuotat e pranimit me institucionet publike të arsimit të lartë....të ciklit të dytë....si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016".

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve pasi diskutoi rreth relacionit paraqitur nga Kancelarja e Universitetit të Arteve të shqyrtuar dhe të paraqitur nga Komisioni përkatës për këtë qëllim sipas tekstit të këtij relacioni vendosi:

VENDOSI

1. Përjashtimin me 50% nga tarifa vjetore e shkollimit të 21 studentëve të tre fakulteteve të Universiteteve të Arteve për vitin akademik 2016-2017.
2. Për vitet akademike në vazhdim këta studentë do të vlerësohen si nga Komisioni i ngritur për këtë qëllim ashtu edhe nga titullarët e Fakulteteve duke marrë për bazë vlerësimin për çdo student, rast pas rasti.
3. Studentët që përfitojnë nga ky vendim dhe kanë bërë pagesën e tarifës së shkollimit të plotë do t'i kthehet 50% e tarifës së paguar.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Elira Kokona
(kryetare)

Prof.Arben Basha
(anëtar)

Arjan KONOMI
(anëtar)

Prof.Artan Peqini
(anëtar)

Dhimitër Bako
(anëtar)

Prof.Besnik Bisha
(anëtar)

Erjon Ndroqi
(anëtar)